

VENDIM
Nr. 524, datë 6.8.2014

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TË AMBIENTEVE TË REPARTIT USHTARAK NR. 5010, NË BUNAVI, VLORË, PËR ZHVILLIMIN E KURSEVE BAZË TË POLICISË, PËR VITIN 2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 6-mujore, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve të Brendshme, të katit të parë e të dytë të objektit nr. 3 dhe të tre poligonëve që ndodhen në repartin ushtarak nr. 5010, në Bunavi, Vlorë, për zhvillimin e kurseve bazë të policisë, për vitin 2014.

2. Ministrisë së Punëve të Brendshme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e ambienteve të repartit ushtarak të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Me përfundimin e kurseve bazë të policisë përpara afatit të përcaktuar në këtë vendim, reparti ushtarak nr. 5010, në Bunavi, Vlorë, t’i kthehet Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme të lidhin një marrëveshje të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama